

### Grupi social dhe proceset ne grup

Po të shikojmë me vëmendje aktivitetet e tona gjatë javës kryesisht janë të përbëra nga grupet me të cilat jetojmë, bashkëveprojmë dhe zhvillohemi. Pjesëmarrja në grupe ka ndikim të madh në sjelljen, të menduarit dhe emocionet e çdo dite.

Si ngrënia e një darkës me farefisën, vizitat nëpër festa, argëtimi me shoqërinë etj etj...

Ç'është Grupi? – anëtarët e grupit duhet të orientohen drejt një a më shumë qëllimesh specifike që kënaqin disa nevoja të përbashkëta ose qëllime dhe norma të përbashkëta. Pra, njëra nga arsytet që njerëzit bëjnë pjesë në grupe është realizimi i qëllimeve, aritja e të cilave lehtësohet nga pjesëmarrja në grup dhe antarësia në grupe është një fenomen universal.

Normat janë pjesë e pandashme e secilit grup që nënkuptojnë sjelljen e ndershmërisë ose rregullin e përcaktuar. Nëse hyjmë në një parti politike ne familjarizohemi me normat e tyre, nëse jemi në studime ne i përmbahemi rregullave dhe qëllimit për studime deri ne diplomim, nëse shkojmë me grupin e devijantëve ne duhet të veprojmë sikurse ata, nëse luajmë një lojë sportive i përcaktojmë metodat e lojës etj etj. Pra, secili grup i ka të përcaktuara normat që i formon në bazë të interesave dhe pëlqimeve të njerëzve që e përbejnë atë grup.



Zgjidhja e problemit në grup- dy mendime japin zgjidhje më të shumta sesa një e vetme, kështu antarët me bagazh të dijes i ndihmojnë anëtarëve më me pak shkathtësi për atë dhe nga shumë eksperimente dalin të dhëna se sasia dhe cilësia është më e evidente në grup sesa individualisht.

Të menduarit në grup- Xhon Kenedi dha urdhërin të bëhet një sulm në Kubë kundër forcave të Kastros dhe më 1961 një grup njerëzish intelektualësh të shquar morën një vendim që më vonë u quajt tejet i dobët. Sepse ata dështuan duke lënë mbi 1200 persona të zënë rob në Kubë. Këtë fenomen e quajmë groupthink sepse doli që grupi i Kenedit kishte injoruar shumë faktorë të qartë vital si për sasinë, fuqinë dhe besnikërinë e forcave të Fidel Kastros. Pra, groupthink-u i referohet "prishjes së efikasitetit të menduarit, testimit të realitetit e gjykimit moral që rezulton nga presioni i unanimitetit brenda grupit duke e censuruar vehten nga mendimet personale.

Koheziviteti i grupit – anëtarët që janë të angazhuar ndaj një grupi të tërheçur fuqishëm prej tij quhet grup koheziv, ku në vehte mbartet aspektet social-psikologjike të ndjenjës së angazhimit dhe pëlqyeshmërisë për grupin.

Faktorët që ndikojnë në kohezionin e grupit janë: Plotësimi i nevojave ku grupi tenton të plotësoj nevojat e secilit anëtarë .

Qëllimet e grupit-Ka shumë qëllime për të cilat një grup mund të organizohet siç është krijimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ,ku nevojat plotësohen në forma detyrash të orientuara ku qëllimi mund të jetë edhe për një prodhimtari të produkteve ose të organizohet një eviniment.

Nga kjo del se njerëz të ndryshëm në të njejtin grup mund të jenë të bashkuar për arsye të ndryshme, megjithatë grupi i cili duket jo efektiv në arritjen e qëllimit për të cilin është organizuar mund të jetë i kohevizitetit të lartë.Kjo ndodh sepse qëllime të tjera mund të bëhen operative dhe të zhvendoset qëllimi origjinal, si më të rëndësishme për ekzistencën e grupit.

Një grup për tu studjuar e interesant është Familja-ne rritemi nën pritshmëritë e prindërve tanë për të adaptuar standardet e tyre të sjelljes së përshtatshme.Por, kur të rritemi ne zëjmë shoqëri jashtë shtëpisë ne i hudhim normat e familjes dhe i adaptojmë ato të moshatarëve tanë ose të mësuesëve, bashkëpunëtorëve, familjes së re etj etj që admirojmë dhe që kemi respekt .

Psikologjia sociale këto i quan grupe referente që kanë për qëllim formimin e vlerave, stileve,e bindjeve për sjelljen e duhur.Shembull në Amerikë studentët që vinin nga familje të pasura i shihnin sindikatat si të rrezikshme dhe njerëzit si radikalë ku me kalimin e viteve të studimit shumë gra e burra kaluan në sistemet liberale nga ato konvencionale dhe si pasojë tentuan të shmangin normat e familjes duke u martuar me persona edhe me ngjyrë. Pra, grupet referente kanë fuqinë e ndryshimit në shumë aspekte jetësore deri te ato më të rëndësishme për jetën politike e sociale të individëve.



Lehtësimi social- Dihet se në garë me dike del më mirë sesa kur jemi vetëm.Sipas Triplett çiklistët çlironin ekstra energji kur ishin me prani të të tjerëve duke pedalar shumë shpejtë.Allport edhe tek fenomenet konjitive ka theksuar se zgjidhjen e problemeve të detyrave e bëjnë më mirë kur janë në garë me disa persona.Këtë dukuri e ka vërejtur edhe tek kafshët ku urithët kanë gurmuar më shumë kur kanë qenë me një numër të madhë.Por studiuesit thojnë se për disa aktivitete njeriu më mirë kontribuon dhe i zgjidh vetëm.Zajonc thotë se prania e personave të tjerë rrit nivelin emocional ku pason ndryshimi fiziologjik si ritmi i zemrës , djersitja dhe aktiviteti hormonal.Gjithashtu mendohet se Zajonc ka shumë aplikime praktike ku ai studio njerëzit familjarë e të shkathët që kryejnë detyra si muzikologë aktorë biznesmen dalin më mirë në prani me publikun sesa vetëm.Pra efekti i pranisë së të tjerëve varet edhe

nga detyra e përcaktuar e individit ku hynë edhe personaliteti dhe temperamenti I tyre.Studimet e sotme përpiqen të gjejnë se në ç'rrethana teoritë e veçanta shpjegojnë në mënyrë efektive të dhënat:

- a) Sipas një teorie ne thjesht kemi një refleks të lindur për t'u bërë më të vëmendshëm e më të ngritur fiziologjikisht kur na rrethojnë të tjerët.
- b) Një tjetër shpjegim është që rritja e rezultati në prani të të tjerëve është një përgjegjje e mësuar –ne jemi të mësuar të shqetësohemi kur të tjerët janë duke na vlerësuar ose e përceptojmë veten si në garë me ta.
- c) Sipas një teorie të tretë , motivimi I rritur rezulton nga dëshira për të kapërcyer hutimin që shkakton prania e të tjerëve.

Hilet sociale- kur një grup merr obligim një detyrë apo realizim të një qëllimi atëherë përgjegjësia shpërndahet dhe secili anëtarë pak a shumë ndjehet rehat karshi këtij fakte ku nuk e jepen energjinë dhe kontributin sikurse kishte me dhënë vetëm.Po si mund të reduktohet ky fenomen.Zgjidhja do të ishte të strukturoheshin situatat grupore në mënyrë që çdo anëtar grupi të ndjehet përgjegjës për rezultatet e grupit si një e tërë . Një teknikë specifike do që të promovohen norma të tilla grupi që theksojnë kontributin individual në rezultatin e grupit.

Psikologja e nënshtrimit- Gjithmonë dikush komandon e dikush bindet apo nënshtrohet.Kështu ka qenë deri më sot në marrëdhëniet midis njerëzve, madje jo vetëm në raportet mes sovranëve dhe të shtypërve por edhe në raportet më të thjeshta shoqërore, në grupe të vogla sociale si në raportet mes 3-4 shokëve si në marrëdhëniet e garave barazia absolute ka qenë e pamundur. Janë vet diferencat fizike,intelektuale, të karakterit, të temperamentit etj që e sjellin fillimisht si tipar biologjik apo trashëgimor.

Ndikimi I familjes si faktor social që mbartë në vehte pushtetin e parë prindëror I shkollës I fesë I propagandës, I edukimit I shtetit sidomos atij diktatorial.Këtu diferencat theksohen .Ndërtimi I shoqërisë është I tillë që një pjesë të mirë të njerëzve , madje edhe nga ata me predispozita për t'u shquar për të komanduar etj t'I bëjë të nënshtruar.Kurse liderët , sovranët dhe komanduesit janë të pakët dhe gjithmone edhe këta I nënshtrohen dikujt si mbretërve , presidentëve etj etj.

Të mëdhenjtë e artit , shkencës dhe kulturës në përgjithësi nuk nënshtrohen sepse ata janë sovran të fushës së tyre dhe mbretërojnë shpesh edhe të vetëm aty siç ka qenë Betoveni,Ajnshtajni Froidi etj ndonëse mjaftë kohë të pakuptuar, te braktisur dhe të pushtuar për një kohë , vazhdonin punën e tyre për të krijuar universin dhe mbretërinë e tyre siç janë edhe poetët Shqiptarë të cilët pavarësisht presionin mijëvjeçar nuk e kanë ndaluar penën duke kërkuar me shpirt poetik lirinë.

